

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, në paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010) dhe nenit 12 paragrafi 12.18 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2015 miratoi si në vijim:

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR TËRHEQJEN E
MJETEVE NGA FKPK PËR PJESËMARRËSIT ME EMIGRIM TË PËRHERSHËM

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi kushteve dhe kriterëve të nevojshme për të vërtetuar se një pjesëmarrës është duke emigruar përherë, si dhe përcaktimi i procedurave që duhet ndjekur për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me kërkesat për transferim të mjeteve pensionale nga FKPK në ndonjë entitet pensional jashtë Kosovës.
2. Kjo Rregullore aplikohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK).

Neni 2

Përkufizimet

Të gjitha termet dhe emërtimet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 (Ligji për Fondet Pensionale të Kosovës) apo sipas përkufizimeve si më poshtë për qëllimi e kësaj Rregulloreje:

1. ***“Llogari individuale e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës”***, nënkupton një llogari për të cilën kujdeset Fondi i Kursimit Pensional të Kosovës, për t’i pasqyruar të gjitha kontributet e paguara në emër të një pjesëmarrësi dhe çfarëdo të ardhurash, shpenzimesh, fitimesh dhe humbjesh të bëra ose që i janë ndarë një pjesëmarrësit.
2. ***“Fond pensional me kontribute të caktuara”***, nënkupton fondin pensional i cili siguron pensione të detyrueshme me kontribute të caktuara.

3. **“Entitet Pensional”**, nënkupton fondin pensional i cili siguron pensione me kontribute të caktuara.
4. **“Emigrim i Përhershëm”**, nënkupton statusin e një pjesëmarrësi që i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.
5. **“Transferim”**, nënkupton transferimin e mjeteve pensionale nga llogaria individuale e një pjesëmarrësi që menaxhohen nga FKPK-ja, e të cilat mund të transferohen te një entitet tjetër pensional jashtë vendit.

Neni 3

Dëshmitë e nevojshme për të përcaktuar se një person është duke emigruar përherë

1. Pjesëmarrësi i cili është duke emigruar përherë duhet të prezantojë në FKPK dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1. Dëshmi që pjesëmarrësi ka shtetësi të një shteti tjetër.
 - 1.2. Dëshmi që pjesëmarrësi ka jetuar jashtë Kosovës në 5 (pesë) vitet e fundit.
 - 1.3. Dëshmi që nuk ka kontribuar në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës në 5 (pesë) vitet e fundit.
 - 1.4. Dëshmi që pjesëmarrësi është regjistruar në një Entitet Pensional që administron fondet e detyrueshme pensionale në shtetin, shtetas i të cilit është dhe konfirmimin nga ky entitet që e pranon transferimin e mjeteve pensionale.

Neni 4

Dëshmitë tjera

Përveç dëshmimeve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, kërkesa për transferim të mjeteve pensionale duhet të shoqërohet edhe me dokumentin se entiteti pensional, që pranon transferimin e mjeteve është i licencuar dhe i mbikëqyrur nga rregullatori i shtetit përkatës.

Neni 5

Marrëveshjet bilaterale ndërshtetërore

FKPK-ja do ta shqyrtojë kërkesat për transferimin e mjeteve pensionale vetëm nëse ka marrëveshje bilaterale ndërshtetërore në fushën e pensioneve të detyrueshme.

Neni 6

Procedurat për trajtimin e kërkesës për transferimin e mjeteve pensionale

1. FKPK-ja do të përgatitë një formular standard, që përmban të dhënat kryesore të pjesëmarrësit, i cili do të plotësohet me rastin e parashtrimit të kërkesës për transferimin e mjeteve pensionale.

2. Kërkesa për transferimin e mjeteve pensionale duhet të parashtrahet me shkrim, të nënshkruhet nga pjesëmarrësi dhe të protokollohet në FKPK. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten të gjitha dëshmitë e përcaktuar në nenet 3 dhe 4 të kësaj Rregullore.
3. FKPK-ja duhet të formojë një komision të përbërë nga tre anëtarë të stafit të tyre, për t'i shqyrtuar kërkesat e pjesëmarrësve lidhur me transferimin e mjeteve pensionale.
4. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni i rekomandon Drejtorit Menaxhues për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën. Vendimi përfundimtar merret nga Drejtori Menaxhues.
5. FKPK-ja merr vendim për aprovimin apo refuzimin e kërkesës për transferimin e mjeteve pensionale brenda afatit prej 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të kërkesës. Për vendimin e marrë FKPK-ja e informon pjesëmarrësin në afat prej 5 ditësh nga dita e vendimmarrjes.

Neni 7

Procedura për transferimin e mjeteve pensionale

1. Transferimi i mjeteve pensionale bëhet drejtpërdrejtë në numrin e llogarisë individuale të pjesëmarrësit në Entitetin Pensional të licencuar nga Rregullatori i shtetit përkatës.
2. Transferimi i mjeteve pensionale duhet të bëhet jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së vendimit për aprovimin e kërkesës për transferim.
3. FKPK-ja me rastin e transferimit duhet të njoftojë pjesëmarrësin për shpenzimet përcjellëse të transferimit, përfshirë ndalesat tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe shpenzimet e tjera.

Neni 8

Zbatimi dhe masat përmirësuese

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara me nenin 33 të Ligjit për Fondet Pensionale.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Bordi i BQK-së.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

Bedri Peci